



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:227728
Datë: 10.03.2025
Numri i dokumentit: 06965330

Ac.nr.6097/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi – kryetar i kolegjit Naim Mehulli dhe Fatmir Baloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Kompania “Debt Loan Recovery SH.P.K.” me seli në Prishtinë, me përfaqësues D.I, kundër të paditurit B.(N).M, nga fshati M....., Komuna e Prishtinës, për rimbursimin e dëmit në vlerë prej 456.00 €, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1995/17, i datës 19.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit B.(N).M, nga fshati M....., Komuna e Prishtinës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1995/17, i datës 19.01.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1995/17, i datës 19.01.2023 ka vendosur si në vijim: “I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë.

II. DETYROHET i padituri B.(N).M, nga fshati M....., Komuna e Prishtinës që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 05.04.2014, t’ia paguaj shumën prej 456.00 €, dhe atë me kamatë prej 8 % e cila do të kalkulohet nga data 03.08.2017 kur është parashtruar padia e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 20 €, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. .”

Kundër këtij aktgjykimi ankesë në afat ligjor ka paraqitur i padituri për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa dhe të ndryshohet aktgjykimi C.nr.1995/17 i datës 19.01.2023 ashtu që padia e paditëses të konsiderohet e parashkruar ose të prishet aktgjykimi dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala paditëse.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195.1 pika d) lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, me datë 04.08.2017 në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit B.N...M.....i nga fshati M..... Komuna e Prishtinës, me të cilën ka kërkuar rimbursimin e dëmit material dhe jo material, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas vlerësimit të provave një nga një dhe të gjitha së bashku të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vërtetimit të gjendjes faktike ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1995/17, i datës 19.01.2023 me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se:” Nga raporti i aksidentit i përpiluar nga Policia e Kosovës me nr. 2014-AR-0715, i datës 05.04.2014 si dhe skica e aksidentit, Gjykata vërtetoi se deri te aksidenti i komunikacionit ka ardhur për shkak se i padituri, i cili ka vozitur automjetin “A” Opel Kadet me targa të regjistrimit 01-189-BD, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit ka kaluar në anën majtë të rrugës me ç’rast e ka goditur shtyllën elektrike, ndërsa me pjesën e majtë e ka goditur automjetin i cili ka qene i parkuar jashtë rrugës, duke i shkaktuar kështu dëme të konsiderueshme materiale.

Nga konfirmimi i sigurimit për automjetin e markës Opel Kadet me targa 01-189-BD i datës 16.03.2014, Gjykata vërtetoi se automobilit Opel Kadet, i regjistruar në emër të **F.B** i kishte skaduar polica e sigurimit me datë 22.02.2014.

Nga paraqitja e dëmit e datës 16.04.2014, akti i vlerësimit të dëmit me numër të lëndës 494/14 i datës 24.04.2014, procesverbali mbi dëmtimin e automjetin me targa 01-296-GA, Gjykata vërtetoi se sipas kërkesës së parashtruar nga i dëmtuari Berat Gashi tani paditësja ka bërë vlerësimin e dëmit të shkaktuar në automjetin e tij si pasojë e aksidentit.

Nga Vendimi i Komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve me numër të dosjes 494/14 i datës 27.04.2014, Gjykata vërtetoi se i njëjti pas shqyrtimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës ka aprovuar kërkesën e të dëmtuarit Berat Gashi për kompensimin e dëmit material në shumën prej 456.00 €. Me rastin e vlerësimit të dëmit, komisioni ka marrë për bazë edhe parametrat teknik dhe të çmimeve standarde në Kosovë për riparimin e një dëmi të tillë.

Nga Vendimi me nr. BKS: FK-494/2014 i datës 29.05.2014, Gjykata vërtetoi se Komisioni i shkallës së dytë e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruar nga i dëmtuari Berat Gashi ndaj Vendimit të shkallës së parë.

Nga ujdia jashtëgjyqësore me nr. 494/14 e datës 05.08.2014, Gjykata vërtetoi se BKS-së dhe Berat Gashi janë pajtuar që BKS - ja t'ia paguaj të dëmtuarit Berat Gashi shumën prej 456.00 € në emër të zhdëmtimit për dëmin material që e ka pësuar në aksidentin e datës 05.04.2014. Në bazë të kësaj ujdie transferi i mjeteve në llogarinë e të dëmtuarit është bërë me datë 18.08.2014 e kjo vërtetohet nga urdhri për transfer me nr. 1224/14 i datës 06.08.2014, si dhe kërkesa e tani paditëses për transfer nga kontoja e saj e parashtruar në Bankën Ekonomike të Kosovës në atë të dëmtuarit.

Pas vlerësimit të provave, në përputhje me dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), Gjykata, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Neni 18 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjia (LSDA-së) parasheh se: “Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”. Ndërsa, sipas paragrafit 4 të të njëjtit nen: “Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat.”

Në rastin konkret, Gjykata ka konstatuar se i padituri me datë 05.04.2014 derisa ka vozitur automobilin i cili nuk ka qenë i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive ka shkaktuar aksident të komunikacionit, me ç'rast e ka goditur automjetin e të dëmtuarit Berat Gashi, duke i shkaktuar dëme materiale. Bazuar në nenin 18 paragrafi 1 të LSDA-së, i dëmtuari ka kërkuar dëmshpërblimin e dëmit nga BKS-ja. BKS-ja pas vlerësimit të dëmit ka nënshkruar Ujdi Jashtëgjyqësore me të dëmtuarin, me të cilin janë pajtuar për shumën që duhet të paguhet për dëmin e shkaktuar si dhe i ka transferua mjetet në llogarinë e të dëmtuarit.

Neni 245 i Ligjit nr. 04/L-077 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve parasheh se: *Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.*

Gjykata ka vlerësuar se paditëses i takon regresi për mjetet e paguara në bazë të Ujdisë jashtëgjyqësore për dëmin të cilin të dëmtuarit ia ka shkaktuar drejtuesi i automjetit, tani i padituri i cili në momentin e aksidentit nuk ka qenë i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive. Prandaj, edhe e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses.

Vendimin mbi kamatën Gjykata e bazoi në nenin 382 të LMD-së, ashtu që kamata do të kalkulohet në shumën e aprovuar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Në përputhje me neni 452 të LPK-së pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyqfituese, t'ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore. Me këtë rast Gjykata e ka aprovuar kërkesën e paditëses për kompensimin e shpenzimeve të procedurës në lartësi prej 20 € për pagesën e taksës gjyqësore për padi. “

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, e aprovon në tërësi vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 tëLPK-së dhe as në shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuese, dhe se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht si dhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Pala ankuese me ankesë nuk ka specifikuar shkelje konkrete ndërsa Gjykata e Apelit me rastin e kezhmainit të aktgjykimit të atakuar nuk ka gjetur se i njëjti është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore në pikët për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në raport me gjendjen faktike gjykata nuk e ekzaminoj aktgjykimin e atakuar sepse vlera e dëmit është vlerë e vogël nën 500 euro dhe nuk lejohet ankesa mbi këtë bazë krej kjo konform nenit 491.1 me të cilin përcaktohet se: *“Aktgjykimi ose aktvendimi me të cilin përfundohet procedura e zgjidhjes së kontestit me vlerë të vogël mund të goditet me ankesë vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.”*

Baza juridike apo e drejta materiale që ia garanton të drejtën e rimbursimit të dëmit palës paditëse nga i padituri përcaktohet me nenin 14.3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia : *“Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese.”*

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur për lartësi të kamatës, pasi kamata është gjykuar konform dispozitës së nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi për shpenzimet e procedurës është i drejtë dhe në përputhje më dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6097/2023 , datë 10.03.2025

Kryetari i Kolegjit - Gjyqtari
Faton Ademi, d.v.